



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Datë 07.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektrezolutës "Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare".

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Artemis Dralo, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Ylli Shehu, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Anduel Xhindi, Elena Xhina dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Luan Harusha dhe Paulin Sterkaj.

Të ftuar:

Taulant Balla- kryetar dhe deputet i Grupit Parlamentar të PS-së

Ervin Bushati – deputet i Grupit Parlamentar të PS-së

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje do të kemi miratimin e projektrezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimi në proceset demokratike”.

Dua të sqaroj kolegët se ky është një propozim i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste dhe deputet i Kuvendit, zoti Taulant Balla, dhe deputetit Ervin Bushati.

Për të prezantuar këtë projektrezolutë do të jenë të dy kolegët.

Ndërkohë dua të kujtoj për çdo koleg procedurën e përcjelljes së kësaj projektrezolute në komision.

Neni 18 i Rregullores i jep të drejtë çdo deputeti të Kuvendit të Shqipërisë dhe, anatyrisht, detyron komisionet e përhershme parlamentare të shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, të ndjekin zbatimin e ligjeve dhe të kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe organeve të tjera qendrore, si dhe u jep të drejtë deputetëve të propozojnë për miratim në Kuvend krahas projektligjeve dhe projektdeklaratave edhe projekt rezolutave.

Pra, kjo është një projektrezolutë që mbështetet pikërisht në nenin 18/1 të Rregullores. Është futur në kalendarin e punës së këtij komisioni dhe e kemi në rendin e ditës së mbledhjes së sotme, sepse në seancën plenare të ditës së hënë me vendim të Kuvendit është vendosur që kjo projektrezolutë të përfshihet në rendin e ditës duke ua ngarkuar për detyrë dy komisioneve parlamentare shqyrtimin dhe miratimin e saj, Komisionit për Politikën e Jashtme, që është komision për dhënie mendimi, dhe Komisionit të Sigurisë, që është komision përgjegjës. Unë kam përpara vendimin e votimit elektronik të kryer në Kuvend. Prezenca në Kuvend ka qenë 108 deputetë, votues kanë qenë 94, ka në votuar pro 92 deputetë, nuk ka votuar asnjë kundër, ka pasur vetëm 2 abstenime. E thashë këtë për të qenë të qartë për procedurën e përfshirjes së kësaj projektrezolute në rendin e ditës së ditës së sotme.

Të gjitha dokumentet i keni përpara: keni tekstin e rezolutës së bashku me relacionin; keni rezolutën e Parlamentit European në anglisht; keni relacionin e Komisionit të Politikës së Jashtme.

Para më shumë se një orë në këtë komision janë paraqitur edhe një grup amendamentesh të bëra nga deputeti Ditmir Bushati, bazuar në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit, ku përcaktohet që deputeti ose Këshilli i Ministrave ka të drejtë të propozojë amendamente me shkrim të arsyetuara, të cilat paraqiten gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës. Përfundimet e komisionit lidhur me to i paraqiten seancës plenare në raportin që harton komisioni përgjegjës.

Pra, këto janë dokumentet tona kryesore të punës. Në rast se gjatës shqyrtimit të kësaj projektrezolute do të kemi nevojë të shqyrtojmë dokumente të tjera, që lidhen ngushtësisht me punën tonë, patjetër do ta bëjmë, por nëse bëhet fjalë për dokumente që janë konfidenciale, ju i dini të gjitha rregullat, mund t'i shikoni patjetër dhe mund t'i konsultoni, ne i kemi bërë gati raportet, seanca për atë moment do të bëhet me dyer të mbyllura dhe pastaj do të rikthehemi për të ftuar median, sepse, natyrisht, pjesa e diskutimit dhe votimit do të bëhet në mënyrë të hapur. Po e bëj këtë paralajmërim që në fillim se, nëse do të ketë një nevojë të tillë, do të mundet ta plotësojnë vetëm deputetët që janë të pajisur me certifikatë sigurie.

Atëherë, i nderuar koleg po jua kaloj fjalën juve për prezantimin e rezolutës.

Taulant Balla – Të nderuar anëtarë të Komisionit të Sigurisë,

Dua t'ju falënderoj për marrjen në shqyrtim me procedurë të përshpejtuar të kësaj rezolute duke vlerësuar rëndësinë që ka njësimi dhe përqasjen e politikës sonë të jashtme, por edhe të politikës sonë të sigurisë kombëtare me të njëjtin qëndrim që ka mbajtur Parlamenti Europian në rezolutën e miratuar më 10 tetor të vitit 2019, rezolutë me të njëjtin emër dhe me përmbajtje të njëjësuar me draftin e rezolutës së depozituar nga ana ime.

Dua t'ju informoj se kjo rezolutë e Parlamentit Europian ka vërejtur me shqetësim se në vendet e Bashkimit Europian, sikurse edhe në SHBA-të, rastet e ndërhyrjes ruse në proceset elektorale kanë shënuar një rritje dhe prej vitesh në shumë vende anëtare janë marrë masa për të ndaluar pjesërisht ose plotësisht dhurimet e huaja për partitë politike ose kandidatët. Me gjithë rregullimet ligjore në legjislacionin e brendshëm, aktorë të huaj përsëri gjejnë mënyra për t'i anashkaluar këto rregulla. Në rezolutën e Parlamentit Europian janë përmendur raste të partive të ndryshme politike në vendet e caktuara të Bashkimit Europian, të cilat kanë marrë financime të huaja nga vende jo miqësore me NATO-n, si aleancë gjeostrategjike, ku ne bëjmë pjesë dhe kemi detyrime sikurse edhe ato.

Në vitin 2018 Bashkimi Europian, në një vendim do ta quajta *in ekstremis*, njoftoi zyrtarisht nisjen e një beteje tjetër, luftën kundër dezinformimit, e cila u ndërmor për të mbrojtur

zgjedhjet që u zhvilluan për Parlamentin Europian nga data 24 deri më 26 maj të vitit 2019. Mënyra e parandalimit të ndërhyrjeve të huaja për eurodeputetët është një iniciativë e përbashkët që përkon edhe me forcimin e taksforcës së përbashkët.

Nëse do të analizonim iniciativat e brendshme rregulluese të vendeve anëtare të Bashkimit Europian për të adresuar këtë fenomen, konstatojmë se nuk ka një formulë të vetme sikurse edhe nuk vijmë këtu me një formulë për të adresuar të dyja këto beteja, për të parandaluar ndërhyrjet e huaja në demokracitë jo vetëm të Shqipërisë në rastin tonë, por edhe të Ballkanit Perëndimor në tërësi, apo sikurse e citon rezoluta në vendet e Bashkimit Europian, por ka raste që, për shembull, Belgjika dhe Danimarka kanë një qasje të përfshirjes së shoqërisë civile në adresimin e lajmeve të rreme. Kam bërë disa akte ligjore, të cilat mund të konsultohen. Nuk do të thosha që janë domeni i punës së Komisionit të Sigurisë Kombëtare, por Kuvendi i Shqipërisë duhet të fillojë pas kësaj rezolute masa konkrete për forcimin e legjislacionit, qoftë në modelin sipas Belgjikës dhe Danimarkës, por përmend edhe rastin e Francës, Gjermanisë dhe Anglisë që kanë miratuar tashmë një legjislacion të fortë në lidhje me dezinformimin dhe përhapjen e lajmeve të rreme. Nëse i referohemi rastit të Francës, vetëm një vit më parë më 20 nëntor të vitit 2018 është miratuar ligji kundër manipulimit të informacionit, i cili kaloi në Asamblenë Kombëtare Franceze me votimin e anëtarëve. Argumentimi pas këtij ligji lidhej me rrezikun që përhapja e lajmeve të rreme i shkakton demokracisë. Po ashtu Gjermania, Britania dhe Italia tashmë kanë ndërmarrë legjislacionin përkatës për ta luftuar këtë fenomen.

Edhe në Kuvendin e Shqipërisë prej disa kohësh është depozituar nga ana e qeverisë “Paketa antishpifje”, pjesë e një beteje të përbashkët me Bashkimin Europian kundër lajmeve të rreme. Gjithashtu, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Europës, kam nderin në krah kryetarin e delegacionit tonë në asamblenë në Këshillin e Europës, zotin Bushati, ka ndërmarrë një sërë rezolutash me këtë tematikë, të cilat janë 22/54, 22/12, 22/75 dhe 22/55, që do t’ju vëmë në dispozicion për t’u konsultuar, sepse drafti i propozuar prej meje, nuk është një draft i mbyllur, por një iniciativë e hapur për t’u pasuruar me të gjitha komentet dhe propozimet nga të gjithë deputetët e të gjitha grupimeve parlamentare. Unë besoj se nuk ka ndonjë Kuvend tjetër në rajon por edhe me gjerë, ku të gjithë të bien dakord se biem dakord se orientimi i Shqipërisë është ai pro europian pro NATO dhe ndërmarrja e iniciativave të tilla nuk bie kurrësi ndesh me strategjitë tona kombëtare të sigurisë dhe politikës së jashtme, por është një rikonfirmim i qasjes 100% në të njëjtën linjë i politikës së jashtme të vendit tonë me BE-në.

Dua ta shpreh se për shkak të kësaj qasje komisionerja në largim për politikën e jashtme, zonja Mogerini, është shprehur se Shqipëria është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor që e ka këtë njësim të politikës së jashtme 100% në të njëjtën linjë me atë të BE-së.

Në fillim të dhjetorit në Kuvendin e Shqipërisë do të jetë Presidenti i Parlamentit European, zoti Sasoli. Ky është një rikonfirmim i bashkëpunimit shumë të mirë që ka Kuvendi i Shqipërisë me Parlamentin European, i cili është një prej tre institucioneve të rëndësishme vendimmarrëse në suazën vendimmarrëse të BE-së, është Këshilli European, ku përfaqësohen vendet anëtare, është Parlamenti European, ku vendet anëtare përfaqësohen përmes deputetëve të secilit prej vendeve dhe të grupuara në grupime të mëdha politike dhe Komisioni European.

Nuk është e para herë , por është rast i përsëritur që Kuvendi i Shqipërisë ka marrë iniciativa që burojnë nga iniciativat e Parlamentit European për të njësuar qëndrimet e veta kundrejt çështjeve themelore. Çështjet e sigurisë kombëtare, çështjet që kanë të bëjnë me ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe beteja që kanë tashmë pjesa më e madhe e vendeve të BE-së dhe dezinformimi janë çështje të rëndësishme.

Në momentin që ne zhvillojmë këtë mbledhje sot në parlamentin britanik ka një kërkesë të deputetëve për t'iu vënë në dispozicion nga ana e qeverisë britanike një raport për ndërhyrjet ruse në Britaninë e Madhe.

Sekretari i SHBA-ve, zoti Pompeu, ka nisur vizitën e tij në Gjermani me mesazhin për t'u kërkuar autoriteteve gjermane të jenë të kujdesshme sa u përket ndërhyrjeve ruse në Gjermani. Kjo do të thotë se kur ky diskutim bëhet për vende anëtare të Bashkimit European edhe ne për shkak të orientimit tonë proatlantik, proeuropean, për shkak se për fat të mirë në Shqipëri nuk ka një forcë politike të vetëdeklaruar kundër kësaj linje, nuk do të thotë që jemi imun për të marrë hapa për të parandaluar të dyja këto fenomene. Pse janë ndërlidhur të dyja këto fenomene në këtë draftrezolutë? Dua t'ju sjell në vëmendje një rast që nuk e përmenda dje në Komisionin e Politikës së Jashtme, nuk besoj se ka qenë e rastësishme që në një moment të caktuar të zhvillimeve politike, të protestave ose të eventeve të tjera gjatë pranverës që kaloi, pranverë që paraprinte vendime të rëndësishme të BE-së lidhur me rrugën europiane të Shqipërisë, pati një zgjim të paimagjinueshëm të interesit të televizionit publik rus "Russian today", e cila transmetonte me orë të tëra protesta të caktuara të një grupimi të caktuar politik.

Nuk besoj se banorët e nderuar të Kamçatkës kanë aq shumë interes për të ndjekur protestat e 300 , 400, 500 apo 700 personave para parlamentit të Shqipërisë ose në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”.

Përdorimi i portaleve të caktuara, sikurse është rasti i Sputnik, e cila shpeshherë është përdorur për të përhapur lajme të rreme në dëm të interesave të Shqipërisë, janë disa shkrime në këtë portal të financuar me fonde publik të vendit që unë përmenda më lart dhe që flasin për Shqipërinë e madhe dhe çështje të tjera, që nuk janë aspak relevante dhe nuk kanë asnjë të vërtetë brenda tyre.

Në këtë kontekst dua t’i kërkoj komisionit tuaj të nderuar që ta marrë në shqyrtim këtë rezolutë. Në këtë komision është ekspertiza, por janë administruar ndër vite informacionet e klasifikuara të Shërbimit Informativ Shtetëror mbi atë, të cilën ne e konsiderojmë ndërhyrje e huaj në Shqipëri, sikurse ka ndodhur edhe në vendet e tjera të Bashkimit Europian. 469 eurodeputetë bashkëndajnë me mua si propozues i kësaj rezolute nevojën për një qasje pank europiane. Pra, kur flas për pakt europian, flas për 28 vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe për vendet e asociuara apo kandidate për anëtarë në Bashkimin Europian dhe Shqipëria duhet domosdoshmërisht ta vijojë këtë qasje, madje jemi vonë për ta forcuar legjislacionin tonë kur bie fjala për financimin e partive politike.

Ne e kemi të ndaluar financimin me burime të huaja të partive politike në Shqipëri kur bie fjala për legjislacionin ekzistues, por besoj se të gjithë janë të informuar që sot në Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë, por edhe nga ana e autoriteteve hetimore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sikurse edhe ato të Skocisë, ka një hetim lidhur me një financim të paligjshëm të ndodhur në dobi të interesave politike të një partie politike të caktuar, e cila nuk është deklaruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga ana e subjektit politik elektoral shqiptar nën hetim.

Kjo rezolutë nuk ka të bëjë fare me këtë rast, për të hequr çdo lloj dyshimi të kujtdo kolegu, por është një indicie për të konkluduar në faktin që legjislacioni ynë ekzistues për kontrollin e financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore nuk është adekuat për të parandaluar çdo lloj forme ndërhyrjeje.

Sa i përket betejës tjetër, asaj kundër disinformimit, nuk besoj se këtu në sallë ka ndonjë prej nesh që nuk ka rënë pre e lajmeve *fake news*, asnjëri prej jush këtu nuk ka shpëtuar nga kjo dhe asnjë shqiptar në 28 mijë kilometra katrorë nuk ka shpëtuar. Po e ripërsëris, rastet flagrante, të cilat janë nën hetim, siç ishte rasti idiotesk i një portali që alarmoi nënat me fëmijë në mes të

natës për të dalë nga shtëpia se kishte arritur të siguronte mjetin apo teknologjinë e parashikimit të tërmeteve, është pikërisht një betejë që duhet fituar domosdoshmërisht.

Në këtë kontekst dua t'ju them se duhet të fillojmë punën, pas miratimit të kësaj rezolute, me paketën antishpifje, për ta pasuruar atë me sa më shumë mekanizma. Më pëlqen ta ricitoj kancelaren Merkel teksa njoftonte rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të 26 shtator 2017, që beteja në atë fushatë elektorale nuk kishte qenë mes ideve, ideologjive, programeve, ekipeve, por kishte qenë një betejë me lajmin e rremë.

Mendoj, të nderuar kolegë, që ky komision ka ekspertizën e nevojshme për ta pasuruar rezolutën edhe me informacionet që ju keni, por patjetër, duke ricituar, kryetare e nderuar Felaj, brenda normës së lejuar që na lejon ligji për informacionin e klasifikuar në Republikën e Shqipërisë.

Diskutimi në këtë komision do të jetë i gjerë, gjithëpërfshirës dhe pa dyshim për të konkluduar dhe për të përfshirë të gjitha amendamentet dhe rekomandimet që vijnë edhe nga kolegët deputetë, edhe nga grupet e caktuara parlamentare me qëllim që të arrijmë në një dokument, i cili na krijon udhërrëfyesin për të filluar një punë të rëndësishme në muajt në vijim, për të forcuar legjislacionin për çdo lloj forme ndërhyrjeje të huaj në proceset elektorale. Ju kujtoj këtu se na ndajnë jo më shumë se 18 muaj nga zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ato të qershorit 2021, dhe që puna përgatitore përkrah asaj që bën Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore duhet të vijojë edhe në komisionet e tjera dhe pa dyshim që Komisioni i Sigurisë Kombëtare ka një rol të pazëvendësueshëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Zoti Bushati, keni diçka për të shtuar?

Dakord.

Përpara se t'ua jap fjalën kolegëve për të bërë pyetje, dua t'ju njoftoj që relatore e kësaj projektrezolute do të jem unë. Kështu që, pa dashur të përsëris atë që prezantoi zoti Balla, më lejoni që, si relatore e kësaj projektrezolute, të shpreh qëndrimin tim për komisionin.

Është e vërtetë që kjo rezolutë vjen menjëherë pas miratimit të një rezolute me të njëjtin titull nga Parlamenti Europian. Pra, në datën 10 tetor të këtij viti Parlamenti Europian ka adaptuar një tekst në trajtën e një rezolute, e cila flet për ndërhyrjet e huaja elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike në vendet e Europës ose të Bashkimit Europian. Kjo rezolutë, ashtu

sikundër e shprehu edhe zoti Balla në fjalën e tij, është votuar me 469 vota pro, 143 vota kundër dhe 47 vota abstenim.

Ne jemi Komisioni për Sigurinë dhe sigurisht që në trajtimin e çdo projektligji apo çdo teksti tjetër të ngjashëm duhet të sigurohemi për aspektin e sigurisë, sepse kjo është detyra që ne kemi të ngarkuar, qoftë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila bën fjalë për komisionet e përhershme parlamentare, qoftë edhe nga Rregullorja e Kuvendit, që është një akt i miratuar me konsensusin e të gjitha forcave politike, që reflektojnë përbërjen politike të Kuvendit të Shqipërisë.

Unë e kam parë rezolutën si shprehje të një qëndrimi politik të vendit tonë. Pra, nuk e kam parë si rezolutë që ne deputetët e bëjmë për veten tonë, por e kam parë si një rezolutë, e cila bëhet për Shqipërinë dhe për Shqiptarët.

Në Strategjinë tonë të Sigurisë Kombëtare thuhet qartësisht që “anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European është objektivi më i rëndësishëm strategjik i vendit gjatë 10 - vjeçarit të ardhshëm. Bashkimi European përfaqëson bashkimin politik dhe ekonomik më të madh në botë, që promovon standarde dhe vlera, të cilat përputhen me aspiratat dhe idealet e popullit shqiptar”. Pra, ne e kemi tanimë të shpallur dhe me anë të kësaj rezolute riafirmojmë perspektivën tonë të qartë europiane pa asnjë dyshim.

Për të realizuar këtë mision, po në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare thuhet shprehimisht: “Integrimi në Bashkimin European lidhet edhe me përfshirjen e vendit në proceset e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe të politikës së përbashkët të sigurisë dhe të mbrojtjes së Bashkimit European”. Pra, ne nuk mund të devijojmë në politikën tonë të jashtme, në politikat tona të sigurisë dhe të mbrojtjes, nga ajo politikë që ndjekin vendet anëtare të Bashkimit European. Këtë e kemi shpallur dhe vendosur që në momentin që miratuar Strategjinë Kombëtare të Sigurisë në vitin 2014.

Çfarë sjell projektrezoluta që na prezantohet sot? Nuk bën asgjë më shumë sesa transponon pika të veçanta të rezolutës së Parlamentit European në një rezolutë për Kuvendin e Shqipërisë.

Unë e kam parë me kujdes dhe prandaj u interesova që dje që ju të kishit edhe tekstin në anglisht të rezolutës së Parlamentit European, pavarësisht se atë mund ta gjeni edhe online. Mund të konfirmoj që shumë pika nga ato që përmban rezoluta e Parlamentit European gjenden fjalë për fjalë në të njëjtën projektrezolutë, fjala vjen, pikat 6, 8, 10, 13, që është përsëritur disa herë, 15, 30, 7, 23, të rezolutës.

Pra, në gjykimin tim, të gjitha ato momente, që ne i kemi konfirmuar si të vërteta edhe në realitetin shqiptar, janë marrë nga kjo rezolutë për t'u projektuar në këtë projektrezolutë, që qëllimin themelor të saj ka të riafirmojë edhe një herë që Shqipëria nuk ka asnjë ndryshim në politikën e saj të jashtme dhe asnjë ndryshim në qasjen e vet ndaj vlerave që prezanton Bashkimi European. Besoj se kjo është shumë e rëndësishme për t'u thënë.

Zoti Balla, do të kisha dashur që ju të mos ishit aq i kursyer në relacion, sepse relacioni, ndonëse nuk botohet në Fletoren Zyrtare, sigurisht që është shumë i domosdoshëm, sepse të gjithë të interesuarit në relacion gjejnë justifikimin publik pse ndërmerret një akt i caktuar. Megjithatë, unë shpresoj që, duke shfrytëzuar edhe diskutimet e kolegëve gjatë ditës së sotme, ne do të mundemi vërtetë të pasurojmë edhe relacionin ose justifikimin publik të kësaj rezolute shumë të nevojshme.

Titulli i rezolutës është: “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike”. Më bën përshtypje që rezoluta e Parlamentit European është shumë e hapur për sa i përket gjuhës. Pra, rezoluta identifikon qartësisht se cilët aktorët, shtetërorë ose jo shtetërorë, që janë dalluar për insistimin e tyre për sa i takon ndërhyrjeve në procese të ndryshme elektorale apo përdorimit të *fake news*.

Dua t'ju referoj në mënyrë specifike që në rezolutën e Parlamentit European, nga e cila merr shkas edhe projektrezoluta jonë, thuhet qartësisht që ka pasur raste, që mediat kanë bërë publike për vende të Bashkimit European, ku parti të ndryshme politike (nuk bëhet fjalë për parti të vogla politike, por bëhet fjalë për parti politike që garojnë për pushtetin në ato vende), kanë marrë financime të huaja. I tillë është rasti i Frontit Nacional në vitin 2016, rasti i Partisë për Liri, *Freedom Party* në Austri, gjë e cila është bërë publike nga media dhe citohet në rezolutë media konkrete dhe data në të cilën është bërë kjo gjë, i tillë është rasti që gazeta “L'Espresso” ka vënë në dukje në datën 10 maj 2019 për Partinë Lega Nord që dihet që ka *premier* Salvinin.

Gjithashtu, dua të theksoj që momenti në të cilin Parlamenti European ka arritur të miratojë këtë rezolutë nuk ka ndodhur papritur. Sigurisht, janë disa rrethana dhe fakte, të cilat kanë çuar në miratimin e kësaj rezolute, të cilat edhe ne, për shkak të përgjegjësiave që ushtrojmë në këtë komision, kemi mundur t'i konstatojmë si të njëjta.

Parlamenti European konsideron qartësisht që për zgjedhjet e veta i është dashur të vendosë dhe të marrë masa në mënyrë që të ndalonte ndërhyrjet në procesin elektoral për Parlamentin European. Vetëm pasi ka marrë ato masa ka arritur në përfundimin që ato ishin të nevojshme, sepse

limituan, megjithatë nuk zhdukën çdo gjë në mënyrë absolute, në mënyrë shumë të mirë ndërhyrjet në procesin elektoral.

Një arsye tjetër që Parlamenti European ngre për nevojën e kësaj rezolute është edhe ajo që lidhet me proceset zgjedhore. Kjo gjë thuhet edhe në titull. Deri në fund të vitit 2020 në vendet e Bashkimit European do të zhvillohen 50 palë zgjedhje, lokale, presidenciale dhe të përgjithshme. Prandaj, Bashkimi European inkurajon të gjitha vendet por jo vetëm, dhe kjo është shumë e rëndësishme për t'i dhënë përgjigje pyetjes: Pse Shqipëria, duke mos qenë vend anëtar, merr e para iniciativën për të bërë një rezolutë të ngjashme? Kjo bëhet, sepse vetë rezoluta e Parlamentit European nuk inkurajon thjesht vendet anëtare të Bashkimit European, por inkurajon edhe vendet kandidatë, që të marrin masa legislative, teknike dhe organizative për të luftuar të dyja këto fenomene: ndërhyrjen e huaj në proceset elektorale dhe dezinformimin.

Pse këto ndërhyrje bëhen kaq të rëndësishme dhe pse invokojnë edhe mendimin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare? Sepse, të gjithë bashkë e pranojmë, proceset elektorale janë të lidhura sa me lirinë dhe të drejtat e njeriut, lirinë themelore të zgjedhjes, aq edhe me pushtetet që vendosen dhe me format që do të kenë këto pushtete. Prandaj, është shumë e rëndësishme që ne të mendojmë që të tilla ndërhyrje e vënë realisht në rrezik sigurinë kombëtare, sepse ato mund të cenojnë sistemin tonë demokratik, që ne kemi zgjedhur, perspektivën tonë europiane dhe, natyrisht, mund të ndikojnë edhe vullnetin e zgjedhësve.

Kjo që po them unë nuk është diçka e re, por që dihet botërisht, siç dihet botërisht që fenomeneve që botën e zhvilluar e prekin më shpejtë, herët a vonë, ne nuk i shpëtojmë dot.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zgjedhjet e fundit presidenciale u kontestuan në masë të gjerë për faktin se rezultoi që miliona llogari të përdoruesve të *facebook*-ut i shin shitur një shoqërie me qendër në Britaninë e Madhe, në mos gaboj. Për këtë arsye, Kongresi Amerikan zhvilloi seancë dëgjimore me Zuckenberg, Komisioni European bëri të njëjtën gjë dhe më tej akoma, kjo rezolutë e Parlamentit European, mbi bazën e të cilës ne po orientojmë një rezolutë për Kuvendin e Shqipërisë, shpreh në mënyrë specifike që ne i kemi vendosur masa të gjithë atyre që kanë rrjete sociale, me qëllim që kushdo përdorues i rrjeteve sociale të mbrohet nga *fake news*.

Është një ko incidencë shumë e mirë që ky komision, jo më larg se dje, përfundoi një konferencë me temë “Cyber security dhe cyber crime”, e cila shumë deputetëve që ishin prezentë gjatë dy ditëve u dha të kuptonin që ne nuk jemi aspak imun ndaj të tilla fenomeneve, që ne sigurisht e kemi pësuar nga të tilla fenomene dhe që ne na duhet fort të rrisim të gjitha kapacitetet

dhe mbi të gjitha të kemi të njëjtin koncept që ka Bashkimi European për luftën ndaj këtyre fenomeneve. Janë mbi 315 milionë përdorues të internetit në Europë, të shërbimeve të ndryshme, përditshmëria e të cilëve dhe shërbimet që ato marrin natyrisht vihen në rrezik edhe nga të ashtuquajturat *fake news*.

Unë nuk po shkoj më tej me këtë pjesë, por dëshiroj ta përmbyll këtu si një moment të parë fjalën time, duke i ftuar kolegët të kujtojnë edhe një herë që nevojat për të cilat është sjell kjo projektrezolutë nuk janë të panjohura për ne. Shumica dërmuese e kolegëve të këtij komisioni në legjislaturën e fundit kanë pasur mundësi të njihen me raporte të Shërbimit Informativ Kombëtar mbi të ashtuquajturat kërcënime hibride.

Unë e thashë që në fillim të mbledhjes që, nëse dikush do të ketë nevojë t'i konsultojë edhe një herë, patjetër që ne jemi të hapur ta bëjmë këtë. E vë në dukje këtë fakt për arsyen e thjeshtë dhe të vetme që asgjë për të cilën flitet në këtë rezolutë nuk është një shpikje e jona, nuk është një ëndërr dhe nuk është një realitet që ndodh diku tjetër dhe nuk ndodh këtu, përkundrazi, është një realitet që është konstatuar këtu, por është konstatuar edhe para se ne të vinim në këtë projektrezolutë.

Së fundi, unë e kam ndjekur me shumë vëmendje diskutimin e kësaj projektrezolute dhe më ka bërë përshtypje fakti pse është aluduar që kjo rezolutë nuk ka objektiva. Sigurish që rezoluta ka objektiva dhe, në gjykimin tim, objektivat i ka shumë të qarta, sepse rezoluta i inkurajon të gjithë aktorët shtetërorë dhe jo shtetërorë, institucionet publike dhe jopublike të marrin masa në drejtim të këtyre fenomeneve; rezoluta inkurajon që ne në shkolla të futim edukimin për “*ProSieben*” dhe kjo është një gjë që u përsërit përgjatë dy ditëve të konferencës me të gjitha vendet e Europës Juglindore.

Ne patëm rastin të përshëndesnim aty shembullin e Serbisë, e cila e kishte futur tanimë në legjislacionin e saj edukimin “*ProSieben*” që në moshë të mitur. Të njëjtën gjë thotë rezoluta e Parlamentit European, e thonë kolegët tanë të rajonit, atëherë pse të mos e bëjmë edhe ne këtë ndaj institucioneve tona. Madje, më vjen mirë të them se është duke u bërë kjo gjë, sepse strategjia kibernetike është urdhëruar që të përgatitet që në fund të vitit 2018 nga Kryeministri dhe ne presim që në dhjetor të vitit 2019 kjo strategji të miratohet. Një ndër masat e kësaj strategjie do të jetë edhe futja në kurrikulën shkollore të programeve të edukimit të fëmijëve tanë për pasojat negative që sjell interneti ndaj tyre dhe ndaj shoqërisë, pa asnjë diskutim.

Kjo rezolutë inkurajon edhe transparencën në financimin e partive politike, që, sigurisht, ka qenë një problem. Unë mendoj se ne nuk kemi nevojë të merremi si shembull dhe të paragjykojemi se këtë rezolutë po e bëjmë për X apo Y person. Jo, nuk kemi nevojë fare. Kjo është një nga çështjet më të debatuar në kontekstin politik shqiptar dhe është një nga momentet më të rëndësishme që Komisioni i Reformës Zgjedhore duhet ta adresojë. Ne kemi ligjin e partive politike. Nuk e di, kolegë, nëse kemi pasur rast t'i kthehemi atij ligji. Bëhet fjalë për një ligj të vjetër të bërë në vitin 1999, ku thuhet shprehimisht se ndalohej financimi i partive politike nga entitetet e huaja shtetërore. A është zbatuar kjo? A ka ndodhur kjo? Jo, ka ngelur thjesht një dispozitë e ligjit të vitit 1999, e cila nuk është pasuar me instrumente të tjera ligjore që të bëjnë të mundur zbatimin asaj dispozite. Për këtë arsye në Shqipëri, sikundër në vendet e tjera europiane, flitet gjithnjë e më shumë për sponsorizime të huaja të fushatave elektorale, më keq akoma për sponsorizime, të cilat nuk deklarohen në Shqipëri dhe, më keq akoma, për sponsorizime që vijnë nga entitete, të cilat i kanë qendrat e tyre në *offshore*. Pra, ju e dini kush i fsheh paratë në *offshore*. Paratë i fshehin të gjithë ata të cilët i kanë fituar si rezultat i ushtrimit të aktiviteteve kriminale. Kështu, të gjitha këto alarme ne, si Kuvend, duhet të na bëjnë të vetëdijshëm që nuk mund të rrimë pasivë. Sigurisht, nuk mund të jemi oportunistë, por ne duhet të vendosim gishtin pikërisht aty ku është problemi dhe të kërkojmë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve. Nëse këtë gjë nuk e bën Kuvendi i Shqipërisë, unë nuk e di kush tjetër mund ta bëjë dhe si do të mundemi ne, që kemi marrë atribut nga të zgjedhurit tanë, të tregohemi indiferentë. Sigurisht, ne nuk mund të jemi indiferentë. Prandaj, me vullnet shumë të mirë i ftoj të gjithë kolegët që ta votojmë tekstin e kësaj projektrezolute të paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, sepse, në fund të fundit, jo thjesht i bëjmë nder vetes, por i japim mundësi hapjes së një kapitulli tjetër të ri pune me legjislacionin tonë dhe me institucionet tona. Në qoftë se ne duam që t'i bëjmë këto të ngjashme me institucionet demokratike që ka Bashkimi European, ky është një moment shumë i rëndësishëm. Edhe nëse nuk e kemi ratifikuar legjislacionin e Bashkimit European, i cili me Kushtetutë nëse ratifikohet, european ose jo, pra ndërkombëtar, bëhet automatikisht pjesë e të drejtës së brendshme dhe zbatohet pa asnjë problem, por, nëse ne nuk kemi mbërritur deri në atë moment, e kemi detyrim që legjislacionin tonë, hartimin e tij, ta orientojmë sipas *acquis communautaire*, sepse nuk mund të bëjmë legjislacion në kundërshti me atë që bën Bashkimi European. Po e mbyll këtu.

Fjalën ia kaloj, zotit Zeneli, sepse jemi në momentin që deputetët të bëjnë pyetje. Ralfi është deputet i këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo cilësi nuk vlen për këtë mbledhje. Ju mund të vini si çdo deputet tjetër, sepse e lejon Rregullorja, por dua që të kemi mirëkuptimin që në pjesën e diskutimit, unë do ta jap fjalën ty dhe kujtdo tjetër që do të vijë, por ju lutem më duhet të respektoj kolegët e Komisionit të Sigurisë, sepse ky është momenti ynë për ta diskutuar. Ju e keni diskutuar në komisionin tuaj dhe jeni të mirëpritur që gjërat t'i thoni edhe në komisionin tonë, si komision përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë, zoti Zeneli, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dikush mund të vijë edhe nga një komision tjetër, por më parë duhet të respektoj kolegët e mi, sepse është hera e parë që e diskutojmë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e Rregullores dhe jo e Ermonelës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, nuk ka nevojë për komente. Kalojmë te pyetjet për relatorin dhe pastaj do të kalojmë te diskutimet.

Ju kërkoj ndjesë, zoti Zeneli, fjala është për ju.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar relatorë të kësaj projektrezolute,

Ne si opozitarë nuk kemi asnjë rezervë për fenomene që cenojnë zgjedhjet apo sigurinë tonë në çdo aspekt, pasi ato duhet të jenë në fokus të punës sonë. Nga informacionet që kemi edhe nga mediet, ju keni pasur brenda Partisë Socialiste një debat për këtë projektrezolutë, të cilën e shoh me pozitivitet, por meqenëse ka edhe një amendament, i cili ka ardhur minutat e fundit në këtë komision e shoh të arsyeshme që të njihemi sa më mirë me këto amendamente. Unë mendoj që mbledhjen ta shtyjme për një ditë tjetër në mënyrë që këto lloj amendamentesh t'i marrim në shqyrtim dhe të dalim me një përfundim sa më të qartë në lidhje me këtë projektrezolutë. Kjo është një kërkesë imja dhe e kolegëve të opozitës, e cila besoj se është edhe brenda Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, prandaj mendoj se nuk do të jetë e nevojshme për ta hedhur në votim.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Zeneli!

Sipas procedurës që na jep Rregullorja do të duhet që fillimisht të kemi mundësinë e shprehjes në parim ndaj projektrezolutës dhe më pas të kalojmë në momentet e tjera. Për këtë arsye i ftova kolegët t'u bënin pyetje propozuesve dhe relatorëve.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, që në fillim dua të deklaroj votën time pro ndaj rezolutës. Gjithashtu, marr shkas nga kolegu im zoti Zeneli, i cili u shpreh se e kishim diskutuar rezolutën te grupi parlamentar për të falënderuar veçanërisht zotin Balla dhe zotin Bushati, të cilët kanë shfrytëzuar kompetencën që u jep Rregullorja e Kuvendit dhe nuk e kanë diskutuar rezolutën fare në grup. Fakti që këtë rezolutë e paraqesin sipas Rregullores së Kuvendit në komisionet respektive tregon që veprimi është i hapur dhe kërkon vendimmarrje nga këto komisione.

Gjithsesi, zoti Balla, për t'u qartësuar më shumë dua t'ju adresoj 2-3 pyetje, të cilat kanë të bëjnë me rezolutën.

Së pari, këtu u citua që rezoluta është në përputhje të plotë me rezolutën që kanë nënshkruar dhe votuar vendet e Bashkimit Europian. Madje, zonja Felaj, na citoi edhe disa përputhshmëri të plota të disa prej neneve, të cilat janë *mot a mot* ashtu siç janë miratuar edhe në Parlamentin Europian. Do të isha i interesuar për pjesën që i takon parlamentit shqiptar dhe neve si komision.

Dua të di, zoti Balla, nëse ky shqetësim ka ardhur te ju në bazë të disa informacioneve që keni marrë nga organet ligjzbatuese shqiptare apo thjesht nga informacione të përgjithshme, të cilat janë bërë medietike? E para.

E dyta, në përfundim të miratimit të kësaj projektrezolute, për të cilën e shpreha votën time paraprakisht, dua të di se cilat do të jenë institucionet përkatëse shqiptare që kanë nevojë të reflektojnë pas përfundimit të kësaj rezolute? Kjo do t'i shërbente sa më saktë dhe më drejtë institucioneve të tilla ligjzbatuese që ato të konfirmojnë në mënyrë të plotë të gjitha paragrafët që janë shkruar.

E treta, zonja kryetare, ju thatë me të drejtë që ne si anëtarë të Komisionit të Sigurisë, madje një pjesë e mirë jona dhe kolegët përballë janë pajisur edhe me certifikatën përkatëse për t'u njohur me materiale sekrete dhe tepër sekrete, shumica prej nesh, ndërkohë që lexojmë rezolutën, kam parasysh raportin e fundit që ka paraqitur Shërbimi Informativ lidhur me problematika të ndryshme vëmë re se ato vërtetë janë shqetësuese qoftë në financim apo në disinformim. Me këtë rast dua të informoj kolegët deputetë, kjo nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me rezolutën, por meqë e mora fjalën,

së bashku me kolegun Vorpsi ju kemi informuar ju, si anëtarë të Komisionit të Sigurisë, dhe i jemi drejtuar kryetarit të Shërbimit Informativ lidhur me një deklaratë të bërë nga Presidenti i Republikës. Dua ta informoj këtë komision të nderuar, që kryetari i Shërbimit Informativ ka vepruar në përputhje të plotë me Rregulloren e Kuvendit, duke më ftuar mua dhe zotin Vorpsi në një takim ku jemi informuar për gjithë problematikën e kërkesës që ne kemi bërë si deputetë, kërkesë e mbështetur në Rregulloren e Kuvendit.

Zoti Balla, duke shpresuar se do të marr përgjigjen e duhur, patjetër dua t'ju konsolidoj edhe një herë mendimin e plotë që vota ime është pro kësaj rezolute.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjala për ju zoti Balla.

Më pas fjalën e ka zoti Murrizi.

Taulant Balla – Duke marrë shkas nga ndërhyrja e zotit Qefalia, i cili kaloi në një çështje që nuk kishte të bënte me çështjen në fjalë, më lejoni që edhe unë në parantezë të përgjigjes së pyetjeve, besoj se si çdo shqiptar tjetër, unë së bashku me ju, jam i gëzuar nga fakti që Alvin Berisha tashmë është në duar të sigurta.

Duke qenë në mjediset e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, do të doja të shprehja falënderimet e të gjithë pranishmëve në këtë sallë, të Kuvendit të Shqipërisë për punën shumë të mirë të kryer nga ministri i Brendshëm, zoti Lleshaj së bashku me një skuadër speciale të forcave tona të policisë. Po ashtu besoj se të gjithë bashkohemi në një falënderim për angazhimin e posaçëm personal të Kryeministrit Rama dhe të Kryeministrit Konte, sepse ky aksion për rikthimin e Alvinit te babai i tij nuk mund të ishte realizuar pa këtë angazhim të përbashkët të dy kryeministrave Rama-Konte, por edhe të njërive speciale të policisë shqiptare dhe asaj italiane.

Në këtë moment që jemi duke folur Alvini po mbërrin në ambasadën italiane në Bejrut, ku do të pajiset me dokumentet identifikuese përkatëse për t'iu bashkuar babait të tij që jeton si emigrant shqiptar në Itali.

Në përgjigje të pyetje që u parashtruan, edhe pse zoti Zeneli nuk kishte një pyetje, më lejoni t'ju sqaroj që diskutimi në Komisionin e Jashtëm nuk ka qenë debat mes meje dhe kolegut tim, anëtar i grupit që unë drejtoj, zotit Ditmir Bushati, por ka qenë një qasje e ndryshme, e cila tashmë ka marrë trajektoren normale të parlamentit dhe të parlamentarizmit. Dua t'ju bëj me dije se të gjitha rekomandimet e propozuara nga zoti Bushati nuk e prekin aspak thelbin e tekstit të

depozituar, pra nuk prekin arsyen e depozitimit të kësaj rezolute, ruajnë integritetin e propozimeve dhe të rezolutës së miratuar nga parlamenti europian, prandaj do t'ju lutesha që t'i përfshinin edhe ato në tekstin integral të kësaj rezolute.

Zoti Qefalia, ju falënderoj për qëndrimin tuaj dhe për pyetjet. Unë jua sqarova që kjo është një nismë e sinqertë që buron nga një qasje e kahershme e njësimin të politikës sonë të jashtme me atë të Bashkimit Europian, por edhe siç jua thashë, kjo është edhe në cilësinë që unë kam si bashkëkryetar i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit Shqipëri-Bashkimi Europian. Nuk është hera e parë që ne marrim nga Parlamenti Europian iniciativa mbi dokumentet e miratuara prej tyre, nuk ndodh rastësisht, por është në mënyrë të përhershme.

Si anëtarë, që prej ditës së ngritjes së Komisionit Parlamentar të Integritetit prej vitit 2005, na ka ndodhur shpesh që në punën tonë parlamentare t'u referohemi dokumenteve të Parlamentit Europian. Sa u përket arsyeve, besoj se këto janë të mjaftueshme për të na bërë që të jemi të vetëdijshëm për masat që duhet të marrim, duke ricituar fjalët e kryetares së këtij komisioni, që ne nuk jemi imun. Dje dhe pardje në Parlamentin e Shqipërisë, është zhvilluar një konferencë me rëndësi të posaçme. Edhe pse për një pjesë të medieve të vendit tonë, kjo lloj konference nuk përbën rëndësi, për ne që jemi këtu dhe që ia dimë vlerën, ajo bëri së bashku parlamentet e të gjithë Europës Juglindore, për një pjesë që është në thelbin e kësaj rezolute: beteja për të siguruar integritetin e rrjeteve tona të informacionit. Krimi kibernetik është dhe do të jetë krimi më problematik në këtë shekull.

Edhe pse zoti Bushati ka propozuar disa amendamente për të përfshirë edhe çështje të qasjes ndaj sulmeve kibernetike, do t'ju lutesha komisionit tuaj, që në bazë të informacionit që ju keni edhe nga organet e tjera ligjzbatuese, sikurse është Shërbimi Informativ Shtetëror apo agjencitë e posaçme për luftën kundër krimit kibernetik, që ta pasuronin edhe ju rezolutën me detyra të detajuara për institucionet që lidhen me këtë pjesë.

Pra, do të thosha se është një mundësi e artë, që në përfundim të kësaj konference rajonale, që u bashkëdrejtua nga zonja Felaj, por edhe pjesëmarrja juaj dhe e përfaqësuesve të tjerë të të gjithë parlamenteve të tjera, që të kemi tre, dy apo një amendament apo rezolutë, si ta mendoni ju, që bën këtë qasje.

Cilat janë institucionet që marrin detyrat? Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka vendosur Kuvendin e Shqipërisë në krye të piramidës institucionale në këtë vend. Jemi të vetmit që mund t'u japim detyra gjithë të tjerëve, duke filluar nga Presidenti i Republikës, nëse doni, duke

vazhduar me Këshillin e Ministrave dhe të gjitha institucionet e tjera. Padyshim, të gjitha këto institucione, qoftë në kuadër të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, qoftë në kuadër të institucioneve të tjera, duhet të marrin e të lexojnë... Është detyrim, nëse ndokush nuk e di, që rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'i dhe të nxjerrin detyrat të gjitha institucionet në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga shembulli që ju përmenda, në lidhje me rastin e Danimarkës e të Belgjikës, kur bëhet fjalë për dezinformimin, unë do të nxisja qoftë komisionin tuaj, qoftë Komisionin e Medieve, në Kuvendin e Shqipërisë, që të organizonim një tryezë të madhe diskutimi me shoqërinë civile, e cila duhet të jetë partnere e jona në betejën kundër lajmit të rremë. Dezinformimi është armiku kryesor i demokracisë në çdo vend.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në gjithë fjalën e iniciuesit të kësaj rezolute, propozuesit, kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Balla, por edhe në sqarimin tuaj shterues si relatore e kësaj rezolute, vura re që ngritët katër argumente, se përse vjen momenti për ta kaluar këtë rezolutë në Parlamentin Shqiptar.

Në argument, së pari, mbështeteni në rezolutën e Parlamentit Europian, të datës 10 tetor.

Së dyti, na u tha gjatë shpjegimeve, parlamenti anglez po kërkon llogari në lidhje me ndërhyrjet ruse në Brexit.

Së treti, ju zonja kryetare, thatë se rusët kanë ndërhyrë fort në zgjedhjet e fundit në SHBA.

Së katërti përmendët një front nacional, që ka marrë lekë nga rusët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me front nacional ne shqiptarët, edhe ti shqiptare je, njohim këta nacional-çlirimtarët. Këta e kanë pasur për nder të merrnin nga rusët deri në vitin 1960.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilët nacionalë janë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, dakord! Ti nuk e cilësove. The: front nacional. Ne më 1960 jemi prishur me Bashkimin Sovjetik. Nacionalja e ka pasur në gojë atë, që nga 1941-shi. Qenka për një front tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo cilësoje atëherë. Se the: fronti nacional, dhe na mërzhiten këta që janë varur në rrugë.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord!

Së pari, desha të dija diçka: duke mos qenë vend anëtar në Bashkimin Europian, se ky i nacionales nuk donte të ishim këtë herë, cila është fuqia detyruese e Parlamentit Europian për Parlamentin Shqiptar? Ne nuk jemi pjesë e Parlamentit Europian.

E dyta, shoh disa paragrafë të rezolutës, ku thuhet: “Duke vlerësuar ndërhyrjet e huaja, duke pasur parasysh ndërhyrjet elektorale të huaja, duke pasur parasysh...”

Pra, sikur ka ndodh, sikur është fakt që ka ndodhur. Organet ligjzbatuese shqiptare kanë raportuar në këtë komision tjera gjëra nga sa shohim në këto paragrafe. Unë personalisht, edhe në raportimet me dyer të mbyllura e konfidenciale, që agjencitë ligjzbatuese kanë bërë në këtë komision, kam pyetur konkretisht për zotin Basha dhe financimet ruse. Përgjigja e dhënë këtu nuk është përgjigje që i shkon për shtat idesë që ne kemi pasur konkretisht përpara, se i lexova me aq sa munda edhe amendamentet e Bushatit një ose dy. Bushati një është këtu, dyshi është ai tjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, Ditmir Bushati. Ajo që unë pashë në të gjitha propozimet e tij, është që të hiqet përdorimi në rezolutë i një shteti specifik. Pra, ai nuk është kundër ndërhyrjeve për të miratuar një rezolutë, që çdo i huaj të mos ndërhyjë në sovranitetin e Shqipërisë. Ai ka hequr vetëm shtetin që është përmendur me emër në rezolutën e propozuar nga ju, si propozues.

Unë personalisht do të isha dakord me Ditmir Bushatin, që na e ka propozuar atë amendament, për arsye që të mos shpallim armiq imagjinarë, duke ndikuar në marrëdhëniet bilaterale të Republikës së Shqipërisë me cilindo vend. Po të fillojmë t’i analizojmë një më një, unë besoj se ne, si vend i vogël, kemi rrezik nga ndërhyrjet, sidomos në ekonomi, nga shumë vende tjera të fuqishme, sepse Rusia mund të jetë e fundit për nga ekonomia në këto biznese strategjike që ka ky vend; janë të tjera para Rusisë. Është thënë në ato lajmet e rreme, se ka ndërhyrje nga Irani, ka ndërhyrje nga pjesa islamike. Unë vetë, si parlamentar, edhe disa rezoluta të parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së, si rezoluta e Bundestagut gjerman... Po atë, e quajmë dot ndërhyrje ne? Edhe ajo detyruese është për Shqipërinë. Parlamenti gjerman e detyron Shqipërinë, sepse ata kanë marrë një vendim, ku thonë: ju duhet të bëni një, dy, tre, katër, pesë. Pra, na urdhëron të fusim hajdutët në burg. A është kjo ndërhyrje në sovranitetin e Republikës së Shqipërisë? Këtu ka përfaqësi diplomatike që marrin rolin e protektorit që prej vitesh, që nga viti 1991.

Ne i kemi cituar jo pak, sipas oreksit. Kur kemi qenë në pushtet dhe na ka ardhur mirë, port të gjitha deklaratat e tyre, u kemi thënë: bravo ju qoftë! Kur kemi qenë në opozitë dhe nuk na ka ardhur mirë, kemi thënë: ç'punë kanë këta?

Në këtë parlament që është dhe në parlamentet që kanë kaluar, janë kritikuar, janë ofenduar këtu me libër shtëpie europarlamentarë. Nga e doni ju? Që nga Doris Pack. Çfarë nuk keni thënë për Doris Pack-un, kur nuk ka folur për ju. Çfarë s'kanë folur, por Genci e ka mbrojtur, Erioni e ka sharë.

Më pas iu lëshuat Mogherini-t. Unë e kam sharë, ju e keni mbrojtur. Pastaj, ju lavdëruar Tanja Fajon-in, sepse mbrojti jastëkun në Parlamentin European, ndërsa ne e shamë, sepse jastëku ishte jastëk dhe nuk mund të bëjmë debat në Parlamentin European për një jastëk.

Pra, të gjitha këto ndërhyrje të individëve të ndryshëm nëpër parlamente të ndryshme, a janë pjesë e kësaj rezolute? Unë nuk besoj të jetë ringjallur dashuria e madhe për komandantin, që të kthehemi në vitin 1960 dhe t'ia përplasim Hrushovit surratit, në mbledhjen e 81 partive në Moskë, dhe kështu e shpallim armikun.

Zonja kryetare tha se neve na kërcënohet siguria kombëtare. Kujt i kërcënohet siguria kombëtare? Neve? Po artikulli 5 i NATO-s na bën më të fortë në të gjithë botën. Jemi anëtarë të NATO-s. Kush guxon të hyjë këtu, tek ne? Ne kemi 28 vende mbrapa, me armatim pa hesap. A jemi vend i sigurtë, si vend anëtar i NATO-s?

Prandaj, nëse është një rezolutë që e keni marrë përsipër vullnetarisht, për të qenë të parët, se kush e tha që jemi të parët që po e bëjmë, në bazë të rezolutës së Parlamentit European, edhe pse ne nuk jemi pjesë, ngaqë këta të nacionales së Ermonelës na votuan kundër, atëherë thoni e do të bëjmë një rezolutë për t'iu hyrë pak në qejf këtyre të Europës, ku po tentojmë të jemi pjesë, që jemi të parët që po vijmë pas jush. Por rezoluta e Parlamentit European nuk përmend emër shteti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke hallin e nacionales ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Epo mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dhe ti, Ermonela, jemi shumë të qartë, se këtu kemi pasur tri agjenci ligjzbatuese konfidenciale, dhe i kemi pyetur konkretisht në lidhje me tallavanë mediatike që është bërë në drejtim të PD-së dhe Lulzim Bashës, që merr lekë nga Putini.

Po të ishte Basha aq i rëndësishëm, sa të kishte shok të ngushtë Putinin, jo do të kishte fituar zgjedhjet, por do të ishte... Ditën kur Basha të bëhet shok i ngushtë me një nga burrat më të fortë të botës, unë do t'i kërkoj fale njëqind herë.

Shefat e shërbimeve kanë pohuar tjetër gjë këtu. Ne u kemi thënë sa është rreziku. Nëse kolegu Qefalia paska informacion në lidhje me atë që ke kërkuar me të drejtë, për deklaratën e Presidentit Meta, ai shefi i shërbimit paska vepruar njëlloj si dikur sekretarët e Byrosë.

Unë jam një ndër atë firmëtarë që kanë kërkuar që edhe ai të jetë këtu. Nëse ai të ka thirrur vetëm ty dhe Vorpsin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aha, thashë se mos ka thirrur vetëm Partinë e Punës dhe na ka lënë ne të partisë së keqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ajo çështje nuk ka lidhje, që të an riktheni këtu. E kemi marrë një vendim për atë.

Myslim Murrizi – Zoti Balla, në parim unë jam për çdo rezolutë që i bën mirë vendit tim, në lidhje me mbrojtjen e pavarësisë, sovranitetit, mosndërhyrjes, për të mos dëmtuar demokracinë, me gjithçka që shoh në artikujt e rezolutës. Në parim.

Pjesa e cilësuar si specifike, kundër një shteti të caktuar, besoj se nuk na bën mirë për të shpallur armiq imagjinarë tridhjetë vjet pasi kemi dalë nga përqendrimi ose përkatësitë e blloqeve, kur ne bënim pjesë në një kamp, ndërsa pjesa tjetër që rreshtuar në kampin tjetër.

Ju faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Më fal një minutë, se u thanë disa gjëra, u citua relatorja, u citua edhe propozuesi.

Që Rusia dhe propaganda e saj në veçanti, përmendet në rezolutën e Parlamentit Europian, kjo është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vetëm pika 'e'. Ke pikën 8, faqja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! E keni tekstin. Mund të mos e kuptosh të gjithin në anglisht, por e sheh qartë. Ke pikën 8, ke pikën 9, ku madje thuhet se Parlamenti Europian ka ngritur një Task Force. Nga të dhënat e kësaj Task Force rezulton se nga janari e deri tani, në tetor, kur është miratuar rezoluta,

janë evidentuar 998 raste të dezinformimit, që është dyfishi i rasteve të evidentuara në të njëjtën periudhë.

Pra, kur unë thashë se më bën përshtypje kjo rezolutë, kjo vinte pikërisht nga fakti se nuk u ngjan rezolutave, të cilave jemi mësuar t'u referohemi ose t'i kemi përpara. Është një rezolutë komplet konkrete, pra që e thotë shprehimisht se nga kush rrezikohet Bashkimi European dhe NATO-ja.

Po ashtu, të ftoj të shohësh pikën 36 të rezolutës së Parlamentit European...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem!

Pra, të shohësh pikën 36 të kësaj, ku thuhet se Bashkimi European, Parlamenti European e vë theksin te fakti se NATO-ja dhe qendrat e ekselencës së NATO-s janë mjet kryesor për të forcuar lidhjet transatlantike midis vendeve të Europës dhe Amerikës së Veriut.

Pra, argumenti sipas të cilit ne jemi një vend i NATO-s që po e merr këtë iniciativë i pari, është një argument plus, favorizues, është një arsye tjetër. Sepse, edhe në themel të politikave të jashtme të NATO-s qëndron ecja paralel me politikat që ndjek aleanca e Atlantikut të Veriut. Kësisoj, nuk ka asnjë diferencë në këtë, pavarësisht se jo të gjitha vendet e Bashkimit European janë edhe vende anëtare të NATO-s, në mos gaboj, se ju jeni edhe anëtar i Delegacionit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

Është e vërtetë ajo që ju thatë, se diferenca e propozimeve që bën zoti Bushati me projektin e propozuar të rezolutës, është pikërisht në faktin se kjo rezolutë e shpreh se nga vjen ky rrezik, pra nuk e mban të fshehtë, por e bën njësoj si Parlamenti European, ndërkohë që teksti i propozuar nga zoti Bushati e heq këtë pjesë.

E fundit që do të thosha, sepse dua të jem konkrete, dhe besoj se je dakord me mua, që gjithmonë kemi nevojë t'u rikthehemi gjërave, për t'i kujtuar si janë: unë i kam parë raportet, dhe ne që jemi këtu e kemi mundësinë që t'i rishikojmë. Unë i kam parë raportet për lehtësi të punës. Në raportin e SHISH-it të datës 12.02.2019, flitet për këto gjëra në faqet 7, 9,10 dhe 11.

Në raportin për ndërhyrjet dhe për kërcënimet hibride...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po unë kam raportin, që të mos rrimë të perfrazojmë ashtu siç e kuptojmë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, unë të ftoj t'i lexosh dhe mos më dëgjo mua. Në raportin e datës 17 shkurt 2017 flitet në paragrafin e parë të faqes 5. Ky është një raport i paraqitur nga Visho Ajazi. Në raportin e datës 13 mars 2018...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo është raporti i tij. Ne kemi marrë raporte në kohën që SHISH-i drejtohej nga Visho dhe raportet që kemi dëgjuar ne. Në raportin e datës 13 mars 2018...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi dëgjuar edhe atë, sepse ka qenë viti 2017 kur raportohej për vitin 2016. Në atë raport do të shikoni diçka shumë interesante. Edhe në raportin e fundit flitet në faqet 7, 10 dhe 11.

Unë i kam gati, ju jeni i pajisur me certifikatë, vetëm duhet të largojmë pak kamerat që t'i shikosh edhe një herë dhe të bindesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Koleg, ky është një dokument zyrtar, ndonëse nuk është publik, që na vihet ne përpara, janë tjetër gjë përgjigjet që marrim me pyetjet tona, ku shpeshherë nuk kemi mbërritur dot deri në detaje, sepse e tillë është natyra e punës që shërbimet informative kanë dhe ligji nuk është shumë i qartë që të dimë se deri në cilat detaje të informacionit mund të shkojmë. Por dokumenti zyrtar mbetet dokument zyrtar. Ai na paraqitet ne, Kryeministrit dhe Presidentit të Republikës. Ne nuk mund të vëmë në dyshim se çfarë është thënë në këto dokumente, për më tepër që këto dokumente nuk janë hartuar tani, që të themi u hartuan me qëllimin për t'u përshtatur. Këto kanë qenë konstatime të një shërbimi, për të cilat ne më herët jemi njoftuar. Nëse dikush ka dyshim për përmbajtjen e asaj se çfarë është thënë, mund t'i shikojë, gjithmonë nëse është i pajisur me certifikatë sigurie. Nëse këtu ka një kërkesë që t'i shikojmë të gjithë, nuk ka asnjë problem, e ndërpresim mbledhjen 20 minuta, që t'i hedhim një shikim të shpejtë, sepse i gjithë raporti nuk flet për të njëjtën gjë, dhe të bindemi që jemi duke shprehur gjëra të vërteta dhe nuk po përpiqemi t'ia hedhim njëri-tjetrit.

Të përgjigjet zoti Balla, meqenëse pyetjet ishin për të, pastaj do të flisni.

Xhemal Qefalia – Për procedurë, unë mendoj se nuk kemi përse ta shfokusojmë mbledhjen. Nuk është marrë në konsideratë nga zoti Balla informacioni që kemi ne si anëtarë të komisionit. Zoti Balla e saktësoi shumë mirë këtë, prandaj të vazhdojmë me procedurën. Ne nuk mund të merremi me materialet që ka sjellë Shërbimi Informativ sot apo nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e rëndësishme fare, ne duhet të vazhdojmë me procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Edhe një herë, procedura po vazhdon normalisht. Ne po vazhdojmë me pyetjet ndaj propozuesit dhe relatorit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ma lini mua këtë përgjegjësi se kush e merr, sepse unë e di se kush është i pajisur me certifikatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne nuk po merremi me materialet. Kush do të merret me materialet le të merret.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alban Zeneli – A mund ta marr fjalën për procedurë, zonja kryetare?

Ermonela Felaj – Po jua jap fjalën që të mos e bllokoni sistemin.

Alban Zeneli – Unë nuk jam nga ata njerëz që i bllokun gjërat. E thashë që në fillim, edhe zoti Murrizi e cilësoi, që ne nuk jemi kundër për asnjë fenomen që cenon sigurinë tonë në çdo aspekt dhe do të mbështesim çdo projektrezolutë apo projektligj në lidhje me këtë gjë.

Unë e falënderoj zotin Balla që në fjalën e tij tha se nuk kishte një debat mes tij dhe zotit Bushati në mbledhjen e Komisionit të Jashtëm. Meqenëse amendamentet e zotit Bushatit nuk e ndryshojnë thelbin e kësaj projektrezolute dhe meqenëse këto amendamente kanë ardhur në minutat e fundit, duke pasur edhe një informacion tjetër që zoti Ruçi, të cilin e falënderoj, e ka hequr, nëse e keni kërkuar ju, edhe juve ju falënderoj, që ne të jemi më të qartë me gjithë projektrezolutën, por edhe me amendamentet, ta shtyjmë këtë debat. Pra, nëse ne do të jemi të qartë se nuk ka asnjë prapavijë tjetër në këtë rast, ne do të jemi pro kësaj projektrezolute.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Nëse e kuptova drejt, propozimi i kolegut në këto momente është i tillë, që ne t'i lëmë kohë vetes për reflektimin e të gjitha amendamenteve të bëra në rezultuë, por ne do ta mbyllim diskutimin për shprehjen në parim ndaj rezolutës.

Fjalën e ka zoti Gjoni

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Balla, a doni të jepni përgjigje?

Ermonela Felaj – Zotit Balla e kishte të drejtën fjalës, sepse i takonte që të pasonte me përgjigjet që bëri zoti Murrizi. Nëse ju keni durim që të prisni edhe përgjigjet e zotit Balla, patjetër. Por, nëse jeni i paduruar për të bërë pyetjen tuaj, ne do ta tolerojmë këtë gjë.

Ralf Gjoni – Nëse zoti Murrizi është i gatshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi e ka zgjedhur vetë se çfarë do të bëjë, ai do të dëgjojë dhe ndërkohë do të konfirmojë.

Ralf Gjoni – Ju falënderoj për tolerancën!

Në Komisionin e Politikës së Jashtme kemi pasur një debat shumë të fortë mes zotit Ditmir Bushati dhe zotit Balla, por edhe unë kam shprehur shqetësimin për përmbajtjen e tekstit të kësaj rezolute.

Së pari, unë mendoj se më takon që t'ju përcjellë edhe shqetësimin që u përmend në Komisionin e Jashtëm nga kryetarja e komisionit, por edhe nga anëtarët që kjo rezolutë, për shkak të implikimeve që ka në politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë, duhej trajtuar dhe dakordësuar në Komisionin e Jashtëm.

Për shkak se ju e keni sjellë këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua më takon...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, kjo duhej trajtuar vetëm nga Komisioni i Jashtë dhe ai duhej të ishte komisioni përgjegjës për këtë. Përse e them këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a ka mundësi ta përfundoj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë të dëgjova, përse ndërhyni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Xhemal, lërin ta përfundojë fjalinë dhe pastaj do t'i marrë të gjitha përgjigjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem me qetësi, përfundojeni mendimin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Teksti i rezolutës që do të votoni në këtë komision ka implikime në politikën ne jashtme të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër mendoj se sugjerimet dhe amendimet e propozuara nga zoti Bushati janë një hap në drejtimin e duhur për përmirësimin e tekstit të kësaj rezolute, e cila me të drejtë u kritikua nga shumë anëtarë të politikës së jashtme për efektet që do të kishte në politikën e jashtme.

Të nderuar kolegë, mua më takon edhe si anëtar zëvendësues i këtij komisioni, por edhe si nënkryetar i Komisionit të Jashtëm t'ju sjell në kujtesë përgjegjësinë tuaj gjatë votimit edhe në parim të kësaj rezolute, për implikimet që kjo rezolutë ka në ushtrimin e politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Zonja kryetare, ju kujtoj se një rezolutë e Parlamentit European nuk ka asnjë efekt detyrues për parlamentin e Republikës së Shqipërisë. Parlamenti European përfaqësohet nga vendet anëtare të Bashkimit European. Nuk ka parlamente të vendeve anëtare të Bashkimi European që të kalojnë në rezolutë me emra shtetesh. Përse e them këtë? Sepse do të ketë implikime në mënyrën se si do të praktikohet politika e jashtme. Nëse përmendim një emër shteti, atëherë do të përmendim edhe emra të shteteve të tjera, të cilat përfaqësojnë një rrezik kombëtar për Republikën e Shqipërisë. Kemi vende në rajon, kemi financime të lëvizjeve islamike, të cilat pretendojnë të paraqiten si parti politike në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ky është një shqetësim që komisioni juaj duhet ta marrë në konsideratë, ndërsa hartohet kjo rezolutë.

Zoti Balla, unë jam pro një rezolute të dakordësuar mes të gjitha grupeve parlamentare, e cila dënon rëndë të gjitha ndërhyrjet e huaja. Këtu ka ndërhyrje të huaja dhe ne nuk jemi kundër kësaj rezolute. Duke marrë shkas nga amendamentet e propozuar të zotit Ditmir Bushati, që janë një reflektim i debatit dhe në Komisionin e Politikës së Jashtme dhe duke marrë shkas edhe nga implikimet dhe një analizë të tërthortë që duhet bërë pjesë: çfarë implikimesh duhet ketë në politikën e jashtme të Shqipërisë? A duhen përmendur emra shtetesh? Nëse po, atëherë të përdorim edhe emra të tjerë, si: Irani, Turqia dhe shtete të tjera. A duhet t'i shtojmë? Nëse duhet t'i shtojmë, ejani t'i shtojmë. Çfarë implikimesh ka kjo në politikën e jashtme? Ne një hap morëm me muxhahedinët e Iranit dhe ju e keni shumë të qartë se çfarë problemesh na ka hapur me Iranin në Shqipëri, ku përfaqësuesja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës flet publikisht për një sulm terrorist që ishte planifikuar në territorin e Shqipërisë. Pra, çfarë implikimi ka një akt i politikës së jashtme të republikës në terrenin dhe infrastrukturën e sigurisë kombëtare të këtij vendi?

Me shumë dashamirësi dhe me shumë konstruktivitet ju sugjeroj që ta shtyni këtë edhe me një javë. Konsultohuni me drejtorët dhe autoritetet e shërbimeve përkatëse, si: SHISH, SHIU dhe AKEP-i, për këtë rezolutë, pra merrni një mendim konsultues nga këto autoriteteve, sepse kur flitet për komisione të huaja, ne në Komisionin e Jashtëm ngritëm shqetësimin se ku është bazuar kjo rezolutë. A ka një dokument? Unë nuk kam të drejtë ta shikoj, sepse nuk kam certifikatë sigurie. A ka një dokument zyrtar dhe një shqetësim për shtete të caktuara?

Më lejonit t'ju kujtoj edhe një gjë tjetër, nëse këtu provohet që Rusia ka financuar partitë politike shqiptare, atëherë ky është një akt i rëndë.

Zoti Balla si pro european, si shtetas european dhe pro amerikan, i bindur prej gjenezës, nëse Rusia ka financuar një parti politike në këtë vend, do të thotë që kjo parti politike ka kryer tradhti kombëtare dhe kemi të bëjmë me implikime penale. Kjo do të thotë që, nëse një parti politike ka kryer një tradhti kombëtare në Republikën e Shqipërisë, kjo ju takon ju si Komision i Sigurisë ta shqyrtoni, do të thotë që kjo parti politike mund të shpallet edhe e paligjshme, apo jo. A do të mbajmë ne në arkitekturën politike të zgjedhjeve parti politike që u shërbejnë interesave armiqësore të huaja lindore? Pra, janë shumë implikime që duhen marrë parasysh, të nderuar kolegë.

Zonja kryetare, unë jam dakord me zotin Zeneli që ta shtyni me një javë. Ejani ta diskutojmë, ne jemi të gatshëm të punojmë edhe mes grupeve parlamentare dhe të hartojmë një tekst të dakordësuar, i cili merr në konsideratë të gjitha këto shqetësime, me qëllim që të jemi sa më dinjitozë në implikimet që ka në politikën e jashtme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gjoni!

Përpara se t'ia kaloj fjalën zotit Balla, detyrohem ta përsëris edhe një herë përse ky projekt është në Komisionin e Sigurisë dhe pse ky komision është komision përgjegjës. Për këtë ka marrë vendim Kuvendi i Shqipërisë dhe është votuar duke mos dal asnjë kundër. Ka edhe një arsye tjetër përse duhet të ishim ne komision përgjegjës, për faktin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, sepse keni votuar edhe ju. Kam këtu të dhënat elektronike nga sistemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e keni parë, kjo është tjetër gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Gjoni, e kam shumë konstruktive gjënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përtej kësaj, politika e jashtme dhe politika e brendshme janë të lidhura ngushtë me sigurinë kombëtare. Si vendos ti të sillesh në arenën ndërkombëtare apo në mjedisin e brendshëm politik, kjo përcakton nëse siguria jote kombëtare vihet në cenim apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po merrem me teatër, por po merrem me një të vërtetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po merrem me një të vërtetë dhe me një logjikë të thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ju keni të drejtë t' i shprehni të gjitha opinionet tuaja, por anëtarët e këtij komisioni kanë përgjegjësi të tjera, kanë komunikim vetë me institucionet, prandaj, sado që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk ju ndërpreva kur ju folët. Ju i bëtë propozimet, tani do t'ia lëmë mbledhjes që të shikojmë se çfarë përgjigje do të marrë propozimi juaj dhe propozimi tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, unë jam duke folur, ndërsa ju më ndërprisni. Ju sqarova edhe një herë që është vendim i Kuvendit që na bën komision përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo nuk kam keqinterpretuar asnjë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, votim i hapur në seancën **04 69** ora 16:22...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në faqen e Kuvendit, është e printuar nga sistemi elektronik në seancën plenare të ditës së hënë.

Ralf Gjoni – Më fal, por për çfarë është votuar atje, për këtë tekst?

Ermonela Felaj – Të lutem, nuk votohet për tekstin, por votohet për komisione. Zoti Gjoni, a ka mundësi të dëgjosh?

Ralf Gjoni – Të lutem, mos tjetërsoni dhe mos keqinterpretoni.

Ermonela Felaj – Edhe një herë, unë po them se për çfarë ka vendosur seanca...

Ralf Gjoni – Nuk është votuar për këtë tekst.

Ermonela Felaj – Nuk ka se si të votohet për tekstin, kur nuk kalohet në komisione. Në seancë është vendosur që kjo projektrezolutë të futet në kalendarin 3-javor. Kur kemi bërë Konferencën e fundit të Kryetarëve, zoti Musaj, më ndihmo, se është pjesë e kësaj Konference, nuk e kemi pasur në kalendarin e punës. Kryetari i Kuvendit me Rregullore ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit futjen e akteve dhe teksteve ligjore në kalendarin e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka bërë këtë gjë duke e futur në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ju e shtruat problemin që ju nuk jeni komision përgjegjës dhe nuk duhet të jeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi komision përgjegjës që çke me të.

Ralf Gjoni – Nuk ishte ky thelbi. Zonja kryetare, unë thashë, për shkak se ka implikime në politikën e jashtme, nuk do të ishte keq që kjo çështje të trajtohej nga Komisioni i Jashtëm.

Ermonela Felaj – Ju e kishit diskutim politik në Komisionin e Politikës së Jashtme.

Ralf Gjoni – Unë nuk e diskutova Komisionin e Sigurisë për rezolutën. Ju lutem, mos i tjetërsoni fjalët! Në asnjë moment nuk e diskutova. Ju thashë: për shkak se këtu ka implikime në politikën e jashtme, që ndoshta ju nuk i kuptoni...

Ermonela Felaj – Patjetër që do ta mbyll, sepse kjo është pa lidhje. Ka implikime në politikën e jashtme, prandaj u caktuan dy komisione: Komisioni i Politikës së Jashtme dhe Komisioni i Sigurisë. Ju ishit dje në komisionin tuaj. Unë kam raportin e komisionit tuaj që më thotë se në këtë komision ndodhën këto diskutime. Komisioni e miratoi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ia bëj unë raportin komisionit. Komisioni ku ti je anëtar, e bën vetë raportin, raportin e kanë para të gjithë anëtarët, le ta shikojnë. Ka propozime në atë raport; ka propozime të sjella veçmas nga zoti Bushati.

Ralf Gjoni – A keni informacion ju për ndërhyrjet tuaja? Ky ishte thelbi. **Ermonela Felaj** – Çfarë është kjo histori e marrjes së fjalës pa lidhje?! *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ti po e ngatërron kot gjënë. Jemi komision përgjegjës. Sugjerimin tuaj të gjithë kolegëve e dëgjuam. Do të mbarojnë diskutimet, sepse nuk mund t'jua heq fjalën kolegëve se thotë dikush:

hajde ta ndërpresim tani. Do t'i dëgjoj të gjithë kolegët, do ta hedh në votim propozimin dhe do të vendosim se çfarë do të bëjmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por ti nuk të lë. Ti thua: “Tani që e thashë unë, merreni vendim ju”. Jo, nuk e marrim vendimin tani. Do t'i dëgjojmë të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sqarohemi më pas, sepse kjo nuk ka vlerë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e kam cilësi gënjeshtren. Tjetërkush mund ta ketë.

Urdhëroni, zoti Balla!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – Zonja kryetare, po u përgjigjem pyetjeve të zotit Murrizi, të cilin e falënderoj për seriozitetin!

Pyetja: pse kjo është koha për të miratuar një rezolutë të tillë në Kuvendin e Shqipërisë?

Ju me të drejtë e keni vënë në dispozicion të anëtarëve të Komisionit të Sigurisë dhe unë, ndoshta, si propozues duhej ta kisha bashkëngjitur si pjesë integrale të relacionit rezolutën të përkthyer në gjuhën shqipe për të qenë e aksesueshme nga të gjithë anëtarët e Kuvendit të Shqipërisë. Ndoshta ju, si komision, mund t'i kërkonit Drejtorisë së Marrëdhënies me Jashtë në Kuvendin e Shqipërisë, departamentit për përkthimet, që ta përkthejë rezolutën. Rezoluta në pikën 10 dhe në pikën 22 flet qartë, madje në pikën 10 sjellë evidencë, që buron nga shërbimi i jashtëm i Bashkimit Europian, për ndërhyrje në demokracitë dhe në sovranitetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor nga këta aktorë të jashtëm. Gjithashtu, në pikën 22 i bën thirrje Bashkimit Europian që, në bashkëpunim me vendet e Ballkanit Perëndimor, të ndërmarrin masat për të përforcuar legjislacionin dhe për të reaguar në mënyrë të përbashkët kundrejt këtyre ndërhyrjeve, por edhe kundër dezinformimit. E kam dëgjuar dje, por e dëgjova edhe sot. Ju lutem, mos e bëni më këtë gabim t'i konsideroni rezolutat e Parlamentit Europian pa vlerë. Është qesharake minimalisht, padije...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem! Kur Parlamentit Europian bën një rezolutë që i kërkon Komisionit Europian apo Këshillit Europian të fillojë bisedimet me Shqipërinë, rrekja se kush do të postojë i pari

falënderimin europian është e paimagjinueshme. Në këtë rast rezoluta e Parlamentit Europian nuk ka vlerë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të kalojnë disa vite që të kuptosh se kanë vlerë. Por do të kalojnë disa vite dhe, nëse do të jesh përsëri në Kuvendin e Shqipërisë, do të kuptosh që kanë shumë vlerë. Jua thashë se në suazën e organigramës vendimmarrëse të Bashkimit Europian kanë shumë vlerë vendimet e Parlamentit Europian. Pa dyshim që këtu kam dëgjuar se edhe rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë nuk kanë vlerë, sepse nuk janë detyruese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Zonja kryetare, ju lutem, respektojeni Rregulloren e Kuvendit dhe etikën, është një deputet që bën shumë zhurmë!

Ermonela Felaj – Po, zoti Balla, është e drejtë, por, me sa duket, programet e edukimit duhet të vazhdojnë, përtej moshës së mitur, edhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Taulant Balla – Dua t’ju sugjeroj të lexonit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sapo është publikuar në një medie shumë të rëndësishme gjermane, të cilën do ta quaja zërin e politikave europiane në Gjermani, “*The European*”, një studim, një analizë e një gazetari gjerman që fillon me titullin “Me porosi të rusëve”. Është një investigim i një gazetari gjerman me reputacion, i publikuar në revistën gjermane “*The European*”, që publikon studime dhe krijon debat në politikën gjermane për çështje të mëdha të këtij lloji, i cili ka studiuar rastin e Shqipërisë. Më thonë që sapo është publikuar. Edhe unë sapo pata mundësi ta shikoja, teksa bëhej pak zhurmë në seancë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, po përgjigjem!

Po ju them se në këtë analizë të publikuar nga ky gazetar, në vijim edhe të asaj që është publikuar nga revista amerikane “*Mother Jones*” (lexojeni, sepse dokumentet janë shumë domethënëse) një parti politike në Shqipëri paska një axhendë tërësisht tjetër dhe pas kësaj ka financime me emra kompanish dhe me emra qytetarësh rusë, të cilët, nga njëra anë, marrin fonde publike në rusi dhe, nga ana tjetër, financojnë lobingun e një partie politike. Lexojeni dhe, nëse ju e vlerësoni, mund ta përfshini edhe atë në relacion apo në rezolutë.

Zoti Murrizi, ju thatë këtu: “Vendimi i Bundestagut apo detyrat e vendosura nga Bundestagu janë ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë”. Jo zotëri, sepse, së pari (edhe këtu do t’i kërkoj Shërbimit të Jashtëm të Kuvendit të Shqipërisë ta përkthejë vendimin e Bundestagut), vendimi i Bundestagut i drejtohet qeverisë federale gjermane, nuk i drejtohet Kuvendit të Shqipërisë apo qeverisë shqiptare. Citoj: “Bundestagu gjerman i kërkon qeverisë federale që një....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Serioziteti është pjesë e rëndësishme e të qenit deputet, por shprehja shqiptare “siç hyre, dole”, mund të funksionojë edhe në rastin tuaj. Unë po ju them: ruani seriozitetin kur flasim për gjëra të mëdha!

Po ju them, zoti Murrizi, se i kërkohet qeverisë federale gjermane që, në komunikim me Komisionin European, të vlerësojë që, nisur nga dokumentet e tjera europiane, ku pa dyshim kriteret e Kopenhagenit janë kriteret bazë që një vend duhet të plotësojë për të qenë pjesë e Bashkimit European, ku flitet për sundimin e ligjit, ku flitet për ekonominë konkurrenciale, ku flitet për të drejtat e njeriut dhe, nëse do t’i lexonit 9 detyrat e shtëpisë të vendosura nga Bundestagu për qeverinë federale si matricë monitorimi për Shqipërinë, kuptohet qartë që nuk është ndërhyrje. Përkundrazi, është një sistem monitorimi për një vendi që sot nuk është pjesë e Bashkimit European, por që të bëhet pjesë e Bashkimit European, që të hapë negociatat me Bashkimin European, duhet të plotësojë këto detyra. Është e papranueshme më besoni që të bëhen këto lloj krahasimesh këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merakun ua heq unë, por, nëse në një komision kuvendor serioz, nuk vihet me duar në xhepa, por mbahen shënime, unë në prezantimin e saj kam thënë që, përveç dokumentit serioz të Parlamentit European, u jam referuar edhe dokumenteve detyruese të anëtarësisë të Shqipërisë në Këshillin e Europës. Nuk jemi anëtarë të Parlamentit European, por, për shkak të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, jemi të detyruar ta përafrojmë legjislacionin e Shqipërisë me atë të Bashkimit European. Kemi filluar përafrimin këtij legjislacioni prej më se 13 vjetësh, nga viti 2006.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, 1 sekondë!

Përafrimi i legjislacionit edhe në domenin e politikës së jashtme apo të sigurisë nuk është mëkat, përkundrazi, është hap pozitiv.

Zotërinj, unë dhe grupi im parlamentar jemi të pozicionuar qartë në rrugën e Shqipërisë përkrah aleatëve tanë strategjikë, Bashkimit Europian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Zgjidheni edhe ju dilemën që keni dhe bujrrëm!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Thelbi i gjithë asaj përgjigjeje shteruese që mora nga ju, ishte deklarata e fundit dhe, sinqerisht, jam absolutisht i kënaqur që nga nr. 2 i Partisë Socialiste, si pasardhëse e Partisë së Punës, deklarohet publikisht përpara meje, si një student i Dhjetorit për ta rrëzuar Partinë e Punës nga pushteti, që qëllimi i kësaj partie të rinovuar nga PPSH-ja është qasja me vrull dhe me frena të këputura drejt Bashkimit Europian. Ne 45 vjet, nga paraardhësit e partisë që sot, zotrote, përfaqëson, po ta çojë ndër mend të përmendje Gjermaninë, kalbeshe në Spaç. Shyqyr... Kur jeni ju pro Gjermanisë, pro BE-së, pro Amerikës, unë që kam dalë me dy gishta në dhjetor të '90-ës, tani nuk besoj se jam bërë më bolshevik dhe ju keni avancuar më shumë?! Këtë lloj kompleksi, po e keni me Lulin, kur ta takoni Lulin, sepse keni 6 muaj që i këndon serenatë poshtë dritares, thojani dhe jo mua. Unë kam qenë në dhjetor të '90-ës, Luli nuk ka qenë, që ta bëjmë partinë tuaj të aksesueshme drejt Bashkimit Europian. Shyqyr që ia arrita kësaj dite! Kjo mbledhje vlejti edhe për këtë.

Unë të falënderoj shumë, zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, si ish-PPSH!

Ermonela Felaj – Edhe ne të përgëzojmë për gëzimin e sinqertë.

Myslim Murrizi – E keni çuar ndër mend se kam qenë ndonjëherë kundër Amerikës dhe kundër Europës unë?!

Taulant Balla – Fakti që ju nuk e ndoqët nga pas Lulin në marrëzinë e tij, më konfirmon të kundërtën. Kështu që jeni në rrugën e duhur.

Ermonela Felaj – Nuk konfirmon thjesht të kundërtën, konfirmon që është konsistent në gjërat e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegë, a ka diskutime, apo pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, kemi propozimin që të ecim me miratimin në parim, ndërkohë përfaqësues nga propozuesit..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam relatore, por dikush tjetër, që do të më bashkohet, patjetër që mund ta caktojme që të punojmë mbi tekstin e projektrezolutës, duke reflektuar ndryshimet që janë bërë nga Komisioni i Politikës së Jashtme, të cilat janë sugjeruar në raportin përkatës dhe amendamentet e sjella dhe të depozituara në komisionin tonë nga zoti Bushati, me qëllim që të kemi një tekst të dakordësuar.

Atëherë, dakord?

Urdhëroni!

Alban Zenelaj – Jam shumë dakord që ju bashkëpunoni për ndryshimet për të dalë me një projektrezolutë të përbashkët. Nëse e doni edhe ndihmën tonë që të japim mendimet tona, duhet ta zgjedhim edhe ne një anëtar. Në qoftë se ju jeni dakord, nuk besoj se ka ndonjë kundërshtim, që ta mbyllim sa më mirë.

Ermonela Felaj – Nuk kemi asnjë kundërshtim, sepse shikoj që edhe propozuesit janë dakord dhe nuk kanë asgjë për këtë. Ne mund të jemi në një grup të përbashkët pune dhe të punojmë me propozimet përkatëse për të pasur në një tekst të dakordësuar.

Ju falënderoj për të gjitha diskutimet, sepse ishin konstruktive!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjoni, nëse do të vish më shpesh në Komisionin e Sigurisë, do ta kuptosh se ne jemi komision i qetë dhe kemi një kulturë tjetër sjelljeje me njëri-tjetrin.

Kush është dakord në parim për miratimin e projektrezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, kolegë dhe punë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA